



Kryetari i Komunës me vendimin Nr. Prot 4873/191, të datës 21.10.2024 ka caktuar komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave në kuadër të Thirrjes Publike "Përkrahja e fermerëve me Serra" me Nr. Prot 2987, të dates 17.9.2024.

Pas marrjes së këtij vendimi, komisioni i caktuar ka filluar menjëherë punën dhe ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha ankesave të fermerëve të cilët nuk kanë qenë përfitues për Serra, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit në Thirrjen Publike "Përkrahja e fermerëve me Serra" me Nr. Prot. 2987 e datës 17.9.2024.

Pas shqyrtimit të të gjitha ankesave të fermerëve, komisioni harton këtë:

## R A P O R T

Komisioni në përbërje të plotë në takimin e mbajtur ka shqyrtuar ankesat e fermerëve të cilët kanë aplikuar për Serra sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuar në Thirrjen Publike "Përkrahja e fermerëve me Serra" me Nr. Prot. 2987 e datës 17.9.2024.

Pas shqyrtimit të ankesave, komisioni ka publikuar listën me ndryshime, që janë 3 (tre), përfitues për Serra.

### LISTA E PËRFITUESVE PËR SERRA PËR VITIN 2025

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Lloji i Serrës
1	Agron Thaqi	Çifllak	5 ari
2	Jeton Morina	Xërxë	5 ari
3	Samed Duraku	K. e Madhe	5 ari

### Vërejtje:

**Të gjithë përfituesit duhet të paraqiten në zyrat e DBPZHR-së për të nënshkruar kontratën dhe të kryejnë participimin prej 20% nga data 06.3.2025 (E enjtë)**

*p.s. në kontratën për projektin "Ndërtimi i Serrave me Participim", pas publikimit të listës së rregullt të përfituesve dhe listës së ankesave të përfituesve, nga komisionet përkatëse, 3 (tre) nga këta përfitues kanë kërkuar që të ju ndryshohet sasia e serrës së përfituar për këto arsye: përfituesit: 1. Agron Thaqi, 2. Jeton Morina, 3. Samed Duraku, kanë kërkuar që nga sasia prej 3*

ari të ndryshohet në 5 ari, për arsye që këta fermer kanë kapacitetin e duhur me sipërfaqe të mjaftueshme të tokës, si dhe me mjete financiare të nevojshme për participimin nga ana e tyre. Kështu që komisioni ka vendosur të bëjë këtë ndryshim pas shqyrtimit dhe komunikimit me fermerët përfitues të cekur më lartë.

Anëtarët e Komisionit:

1. Kryesues 

2. Anëtare 

3. Anëtare 